STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 15 mars 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON FILLIMIN E RINDERTIMIT TE ASFALTIT NE OCEAN PARKWAY TE LONG AJLEND (LONG ISLAND)

Rindërtimi i autostradës së Long Ajlënd (Long Island) është në plan për të përfunduar deri në Ditën e Përkujtimit

DOT i Shtetit dhe Komisionerët e Parkut theksojnë përparimin e rindërtimit prej 32.2 milionë dollarë të Parkway, Dunave të Rërës dhe Rrethit të Trafikut të Parkut Shtetëror Robert Mousis (Robert Moses) të dëmtuar nga super stuhia Sendi (Sandy)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se një projekt prej 32.2 milionë dollarë për të restauruar Ocean Parkway në Long Ajlënd (Long Island) është duke arritur një pikë të rëndësishme këtë javë me fillimin e rindërtimit të asfaltit vetëm katër muaj pasi super stuhia Sendi (Sandy) shkatërroi rrugën anash oqeanit dhe disa milje të plazheve përgjatë tij.

"Ocean Parkway dhe lidhjet e saj me Parkun Shtetëror Robert Mousis (Robert Moses) janë të rëndësishme për cilësinë e jetës dhe mirëqënien ekonomike të Long Ajlënd (Long Island)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Agjencitë vendore, shtetërore dhe federale kanë punuar shpejt dhe në bashkëpunim për të riparuar dëmin në Parkway të shkaktuar nga super stuhia Sendi (Sandy) dhe jam i gëzuar të njoftoj se janë sipas planit dhe buxhetit për t'a përfunduar këtë projekt deri në Ditën e Përkujtimit."

Komisionerja e Departamentit Shtetëror të Transportit (State Department of Transportation) Xhoen Mekdonald (Joan McDonald) dhe Komisionerja e Zyrës Shtetërore të Parqeve, Zbavitjes dhe Ruajtjes Historike (State Office of Parks, Recreation and Historic Preservation) (OPRHP) Rouz Harvi (Rose Harvey) sot bënë një vizitë tek projekti, që përfshin zëvendësimin e një pjese prej dy milje të Ocean Parkway të shkatërruar pranë Gilgo Biç (Gilgo Beach) dhe zëvendësimin e korsive të dëmtuara në rrethin e trafikut në Parkun Shtetëror Robert Mousis (Robert Moses). Projekti gjithashtu është duke zëvendësuar pesë milje të dunave mbrojtëse të rërës që i kishte marë stuhia dhe zëvendësimin e bimëve vendase përgjatë dunave.

“Guvernatori Kuomo (Cuomo) drejtoi një reagim të shpejtë ndaj dëmtimit të kësaj autostrade dhe agjencitë tona partnere dhe kontraktorët e projektit janë duke e bërë atë një realitet,” tha Komisionerja e Departamentit Shtetëror të Transportit (State Department of Transportation) Xhoen Mekdonald (Joan McDonald). “Ocean Parkway transporton pothuajse 10 milionë vizitorë në vit në plazhe dhe parqe përgjatë vijës bregdetare jugore të Long Ajlënd (Long Island). Kemi zbatuar një metodë të përgjithshme ndaj rindërtimit të rrugës dhe të dunave të rërës që e mbrojnë atë, duke siguruar se Parkway është gati për sezonin turistik të verës dhe dëmi në të ardhmen të minimizohet.”

Komisionerja e Parqeve Shtetërore (State Parks) Rouz Harvi (Rose Harvey) tha, “Jam mirënjohëse ndaj Guvernatorit Kuomo (Cuomo) dhe partnerëve të mi në qeveri për punën e shpejt me riparimin e Ocean Parkway dhe rindërtimin e dunave që ndihmojnë në mbrojtjen e vijës bregdetare të mahnitshme të Long Ajlënd (Long Island) në mënyrë që banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) të jenë në gjendje të gëzojnë plazhet e tyre këtë verë.”

Komisioneri i Departamentit Shtetëror të Ruajtjes Mjedisore (State Department of Environmental Conservation) Xhozef Martens (Joseph Martens) tha, "DEC do të vazhdojë të punojë me agjencitë federale dhe shtetërore për të gjetur sasi të përshtatshme rëre për projektet e rindërtimit dhe rigjallërimit të plazheve anembanë Long Ajlënd (Long Island). Rigjallërimi i plazheve është një hap i rëndësishëm në mbrojtjen e Long Ajlënd (Long Island) gjatë ngjarjeve të stuhive në të ardhmen dhe ky projekt i përshpejtuar do të bëjë pikërisht atë."

Projekti i ndërtimit është duke u bërë nga një sipërmarrje e përbashkët e tre kontraktorëve me qendër në Nju Jork (New York) John P. Picone, Bove Industries dhe Tully Construction. Projekti është duke u bashkërenduar mes dhjetë agjencive dhe autoriteteve të ndryshme federale dhe shtetërore.

Anëtari i Kongresit Tim Bishop tha, “Infrastruktura e rëndësishme anembanë Long Ajlënd (Long Island) u shkatërrua nga super stuhia Sendi (Sandy) dhe restaurimi i Ocean Parkway është një hap i parë i mirëpritur në procesin e gjatë të rindërtimit të komuniteteve tona. Rimëkëmbja nga dëmi që shtrihet nga Long Biç (Long Beach) në Pikën Montauk (Montauk Point) dhe forcimi i mbrojtjeve tona kundër stuhive në të ardhmen do të kërkojë një përkushtim të qëndrueshëm dhe bashkërendim të vazhdueshëm ndërmjet të gjitha niveleve të qeverisë.”

Senatori i Shtetit të Nju Jorkut (New York State) Çarls J. Fushilo Jr. (Charles J. Fuschillo, Jr.), Kryetar i Komitetit të Transportit të Senatit (Senate's Transportation Committee) tha, “Ocean Parkway është një rrugë e rëndësishme dhe e përdorur gjerësisht, e cila sjell banorë dhe vizitorë në vijën bregdetare jugore të bukur të Long Ajlënd (Long Island). Përfundimi i këtij projekti të riparimit dhe restaurimit deri në Ditën e Përkujtimit do të sigurojë se plazhet dhe parqet përgjatë Ocean Parkway do të jenë në gjendje t’u shërbejnë miliona njerëzve që i përdorin ato çdo verë. Falënderoj secilin të përfshirë në këtë projekt për punën e tyre të vështirë për t’u siguruar se përfundon në kohë dhe sipas buxhetit.”

Anëtari i Asamblesë Dejvid G. Megdono (David G. McDonough) tha, "Dëshiroj të përgëzoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo), Departamentin e Transportit të Shtetit të Nju Jorkut (New York State Department of

Transportation), Zyrën e Parqeve, Zbavitjes dhe Ruajtjes Historike (Office of Parks, Recreation and Historic Preservation) për veprimin e tyre të shpejtë në riparimin e kësaj rruge, e cila pësoi dëm të rëndë nga super stuhia Sendi (Sandy). Ocean Parkway siguron mundësinë e nevoshme për tek plazhet e shkëlqyera të Long Ajlënd (Long Island)."

Zyrtari i Qarkut Safolk (Suffolk County) Stiv Bellone (Steve Bellone), "Përgëzoj Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për udhëheqjen dhe bashkërendimin e një reagimi të shpejtë për rindërtimin dhe restaurimin e nevojshëm në Ocean Parkway. Ocean Parkway siguron një portë për në plazhet e Long Ajlënd (Long Island), që janë kaq vendimtarë për gjallërinë ekonomike të Qarkut Safolk (Suffolk County). Përfundimi i planifikuar i projektit do të shërbejë si lajm i mirëpritur për bizneset që varen nga turizmi i verës dhe për banorët që gëzojnë plazhet gjatë gjithë vitit."

Zyrtari i Qarkut Naso (Nassau County) Eduart P. Mangano (Edward P. Mangano) tha, "Përgëzoj përpjekjet e Guvernatorit Kuomo (Cuomo) dhe secilin të përfshirë për reagimin e tyre të shpejtë ndaj kësaj rruge jetësore që ndikon jo vetëm cilësinë e jetës tonë, por gjithashtu për shumë në jetesën e tyre. Duke punuar së bashku do të vazhdojmë të shohim arritje të jashtëzakonshme ndërsa rimëkëmbemi nga super stuhia Sendi (Sandy)."

Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Kontraktorëve të Long Ajlënd (Long Island) Mark Herbst (Marc Herbst) tha, "Jemi të gëzuar t'u bashkohemi Komisioneres Mekdonald (McDonald) dhe zyrtarëve shtetërore në vlerësimin se restaurimi i Ocean Parkway është sipas planit për sezonin e verës, duke treguar qartë vendosmërinë e anëtarëve të LICA-s, Bove Industries, Inc. dhe Tully Construction Co., Inc., dhe të gjitha zanateve të ndërtimit të Long Ajlënd (Long Island). Ky përparim i jashtëzakonshëm jo vetëm që tregon qartë përkushtimin e tyre në kushtet më të vështira, por gatishmërinë e punëtorëve të industrisë dhe të pajisjeve tona për t'a kryer punën."

Ocean Parkway është një autostradë 15.5 milje e gjatë që siguron hyrjen e udhëtarëve dhe lidh publikun me shumë komunitete të admiruara zbavitje dhe të banimit përgjatë bregut jugor të Long Ajlënd (Long Island). Super stuhia Sendi (Sandy) shkaktoi dëm të pashembullt në rrugë dhe dunat mbrojtëse, duke e mbyllur plotësisht rrugën për pothuajse një muaj. Departamenti i Transportit i Shtetit të Nju Jorkut (New York State Department of Transportation) (NYSDOT) përfundoi punën e emergjencës për të rihapur rrugën me kufizime të korsive dhe të shpejtësisë në 24 nëntor.

NYSDOT, Zyra Shtetërore e Parqeve, Zbavitjes dhe Ruajtjes Historike (State Office of Parks, Recreation and Historic Preservation) dhe Departamentit i Ruajtjes Mjedisore i Shtetit të New Yorkut (New York State Department of Environmental Conservation) janë duke bashkëpunuar me Administratën Federale të Autostradave (Federal Highway Administration) dhe Korpusin e Inxhinierëve të Ushtrisë së SHBA-së (U.S. Army Corps of Engineers) në projektin e restaurimit.

Projekti kërkon që nën-kontraktori Norfolk Dredging, i Virxhinias (Virginia), të dërgojë me tubacion 800,000 jardë kub rërë nga Gjiri i Fajër Ajlënd (Fire Island Inlet) pothuajse tre milje në breg, kur kamionat janë duke e transportuar atë për të rindërtuar dunat e rërës. Ajo është aq rërë e mjaftueshme për të

mbushur një fushë futbolli me lartësi 38 kate. Gërmimi filloi në 8 shkurt dhe pjesa më e madhe e dunave janë rindërtuar.

Rindërtimi i Ocean Parkway filloi këtë javë, që përfshin zëvendësimin e dy miljeve të sipërfaqes prej betoni të rrugës.

Administrata Federale e Autostradave (Federal Highway Administration) do të financojë shumicën e punës së riparimit dhe restaurimit nëpërmjet programit të saj të Ndihmës për Emergjencat.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418